



PROCESVERBALI

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.07.2018, me fillim në ora 10.15.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje kemi, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar,
2. Shqyrtimi i Raporti gjashtë mujor financiar për vitin 2018,
3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017,
4. Shqyrtimi i informatës mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së,
5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P - 71510057- 06249 – 0,
6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510056 – 02240 - 1,
7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510057 – 02267 – 0,
8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510068 – 01396 - 0,
9. Të ndryshme.

Pika shtesë

1. Shqyrtimi i Kërkesës së Kryetarit të këshillit të prindërve të Komunës së Rahovecit.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një propozim për një pikë shtesë, nëse edhe ju jeni të pajtimit, besoj se të gjithë e keni marrë një kërkesë në email adrës nga kryetari i këshillit të prindërve të arsimit z. Ymret Reshiti, kërkesa e tij është që ti paguhet mëditja kur merë pjesë si anëtar i këshillit të prindërve të arsimit në KKSB-së, sepse ai është anëtar i këtij këshill. Kërkesa ime është që kjo pikë të jetë si pikë shtesë sot dhe pastaj të kalojë si pikë e rregullt në mbledhje të Kuvendit, ndërsa a do të aprovohet apo jo në kuvend ajo është çështje e kuvendarëve se si vendosin. I lusë anëtarët e KPF-së që ta përkrahin këtë propozim.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e kuvendarit z. Fehmi Cena: Konstatoj se me 4 vota pro, 1 abstenim ka kaluar propozimi i z. Fehmi Cena që si pikë shtesë për Kuvend të jetë Kërkesa e Kryetarit të këshillit të prindërve të arsimit të Komunës së Rahovecit.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj kërkesë edhe unë e kam pranuar në email, do të isha pajtuar plotësisht nëse do të rishqyrtohet vendimi që është marrë në Kuvend për pagesën e mëditjeve se sa me kërkesa individuale, në këtë çështje e kemi diskutuar me vite të tëra, por gjithmonë arsyetimi nga ekzekutivi ka qenë që shërbyesit civilë pa mare parasysh se në cilin komision ose komitet janë të përfshirë nuk ju takon mëditja. Nëse dikush nga ekzekutivi dele e na tregon një udhëzim administrativ se a ju takon shërbyesve civilë që të ju paguhet mëditja, pastaj besoj se ne si anëtarë të kuvendit do të marrim një vendim të përgjithshëm. Gjithmonë kam qenë që të gjitha ata shërbyesit civilë që punojnë jashtë orarit të punës të paguhen, por nuk jam kompetent për këtë.

Fehmi Cena – I nderuar Kryesues propozimi u votua që të jetë si pikë shtesë i rendit të ditës, ne nuk kemi se çka të diskutojmë tani, në kuvend do të diskutojmë dhe atje do të vendoset a të paguhen apo jo.

Isak Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kamë parë këtë kërkesë sepse ju është drejtuar edhe Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikave të komunave tjera nuk paguhen,, madje disa komuna nuk i paguajnë edhe ata të cilët nuk marrin pagë nga buxheti i Kosovës sepse ata e bëjnë në mënyrë vullnetare. Asnjë komunë deri më tani nuk i paguan mëditjet zyrtarëve të cilët marrin pagë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, në këtë rast e kemi FSK-në e cila nuk paguhet, policinë e Kosovës, zyrtarë të KLSP-ve, drejtorë shkollave etj. Asnjëri nga këta nuk paguhen në KKSB, aktualisht mëditje marrin në këtë këshill vetëm anëtarët të cilët nuk marrin pagë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, kjo është përgjigja ime po ashtu edhe në Kuvend kjo përgjigje do të jetë dhe nëse është e nevojshme edhe deri në gjykatë.

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës me një pikë shtesë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga Mbledhja e Kaluar.

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit, nëse jo e qes në aprovim pikën e parë të rendit të ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë. Kalojmë në pikën e dytë.

2. Shqyrtimi i Raporti gjashtë mujor financiar për vitin 2018.

Afrim Limani - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtori Limani paraqiti në detale raportin 6 mujor financiar para anëtarëve të Kuvendit, ku më pas kanë pasuar pyetjet nga ana e kuvendarëve.

Dërvish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se tani nuk mundemi ta shqyrtojmë këtë pikë të rednit të ditës për shkak të mungesës së materialit, ne nuk kemi mundur me e shfletu këtë material në mënyrë që pastaj të japim një kontribute të mjaftueshëm. Mendoj se për këtë pikë kontribute më të madh do të japim në mbledhje të kuvendit.

Florije Boshnjaku – Mos ardhmja me kohë e materialit të këtij raporti në kuvend është duke na u përsëritur vazhdimisht që sa vite që jemi në kuvend, arsyen e dhe edhe drejtori i financave, pasi një herë duhet që ky raporte të shkojë në financa dhe pastaj në kuvend kurse afati kohorë është shumë i shkurtër. Por aq sa pata mundësi me e shfletu do të diskutoj, sa i përket të hyrave vetanake ka ngritje dhe për këtë ju përgëzoj drejtor dhe shpresoj se në të ardhmen më tepër do të ketë rritje, normal duke e dhënë edhe ne një kontribut. Por ajo që më tërhoqi vëmendjen ishte të hyrat nga gjykatat kishte rrënjë nga 21,000.00 € në 15,000.00 €, a keni ndonjë informatë rreth kësaj. Pastaj tek faqe nr. 18 shpenzimet e varrimit në vitin 2017 nuk është bërë asnjë pagesë kurse në vitin 2018 kemi pagesë më shumë se 35,000.00 €, pyetje ime është a është borxh i bartur nga vitet paraprake apo borxh i këtij viti.

Fehmi Cena – Pajtohem me parafolësin z. Dervish Çadraku i cili e potencoi se materiali na ka ardhur me vonesë dhe koha nuk na ka premtuar që ta përpunojmë pak më mirë këtë material, ky material është mjaft i gjer dhe me shumë shifra, por sidoqoftë aq kohë sa kemi pasur e kemi shfletuar këtë material aq sa kemi mundur. Sa i përket dizajnit të raportit mendoj se është mjaftë i mirë për ta lexuar, shifrat janë të dhëna edhe në mënyrë tabelar, u përmend edhe nga znj. Florije dhe nga Drejtori se ka pasur rritje të buxhetit, por mendoj se kjo rritje është mjaftë simbolike. Nëse ne e krahasojmë planifikimin 1,650,000.00 € që është planifikuar të ketë të hyra, ndërsa për 6 mujorin e parë ka të hyra prej 456,000.00 € ku me përqindje i bie 27.64%, kjo përqindje nuk është inkurajuese, megjithatë urojmë që në gjashtë mujorin e dytë të ketë të hyra më të mëdha. Në faqe nr.5 të hyrat nga gjërat në trafik dhe gjykatat janë disa shifra të cilat nuk i kuptoj, në tabelat lartë janë të cekura gjërat në

trafik të hyrat e vitit 2018 shuma 10,595.00 €, kurse pak më poshtë ceket shuma prej 46,341.00 €, po ashtu edhe gjobat në gjykata më lartë ceket shuma prej 9,244.00 €, kurse më poshtë ceket 15,639.00 €, këtë diferencë nuk jam duke e marr vesh, por shpresoj se drejtori do na jepe më shumë shpjegime. Pastaj më poshtë ku ceket totali i të hyrave, plani për vitin 2018, është kjo shifër e tejkalimit të planit 1,151,000.00 €, mendoj mos është bërë ndonjë gabim sepse nëse e zbrisim 518,000.00 € nuk mbetet shuma prej 1,151,000.00 € por mbetet 1,131,000.00 €. Ne faqe nr.6 të hyrat në shëndetësi janë planifikuar 48,000.00 € për 6 mujorëshin, ndërsa të realizuara i kemi 16,000.00 €, ku në përqindje i bie 33 %, mendoj se për mbledhje të ardhshme të Kuvendit Drejtori i Shëndetësisë duhet që të na jepe pak më shumë shpjegime rreth kësaj. Tek tabela nr.8 ankesat për tatimin në pronë për vitin 2018 nuk është cekur asnjë ankesë, a nuk ka pasur me të vërtet asnjë ankesë për 6 mujorin e vitit 2018. Tek tabela nr.10 po ashtu sa i përket donacioneve nuk ka kurrfarë shënime, a ka pasur donacione në këtë 6 mujor apo nuk ka pasur, mendoj nëse ka pasur sado pak është dashur që të regjistrohen në mënyrë që ne të dimë se nga kush ka pasur donacione Komuna jonë. Ajo që të bije në sy tek shpenzimet në mallra dhe shërbime është se në çdo tabelë kemi rritje të shpenzimeve dyfish në krahasim me vitin e kaluar. Kjo ishte në pika të shkurtra, në mbledhje të kuvendit do të diskutojmë më gjerësisht.

Afrim Limani – Do ju përgjigjem fillimisht pyetjeve të znj. Florije Boshnjaku, është e vërtet që kemi rritje të hyrave vetanake si ato të rregullta si dhe nga gjobat e gjykatave dhe të trafikut, ne e konsiderojmë një rritje të mirë por e cila ka mundur të jetë edhe më e madhe. Sa i përket shpenzimeve të varrimit në vitin 2017 këto shpenzime janë bërë nga kategoria e subvencioneve, pikërisht në këtë pikë ka dhënë vërejtje edhe auditori i jashtëm dhe pas sugjerimeve të auditorit ne kemi filluar që shpenzimet e varrimit që ti paguajmë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Pastaj në këtë shumë është edhe një obligim nga viti i kaluar të cilin e kemi kryer këtë vit, shumën nuk e di saktë tani. Z. Fehmi Cena i bëri disa pyetje, i nderuar pajtohem me ju në shumë gjëra dhe ky raport mundet po ashtu të ketë edhe gabime teknike, disa i kam vërejtur edhe unë, por për hire të korrektësisë ndaj jush ne kemi punuar edhe me orare të zgjatur vetëm që ta përfundojmë sa më shpejtë këtë raport në mënyrë që të jetë në duart e juaja dhe ne nuk kemi pasur kohë të ta kontrollojmë edhe një herë., por ju siguroj se për mbledhje të kuvendit do të përmirësohen. Sa i përket ankesave nga tatimi në pronë, i nderuar deri në momentin e dorëzimit të këtij raporti ne nuk kemi pasur ndonjë raport të shqyrtimit të ankesave. Në donacione në sistemin SIMF regjistrohen të gjitha donacione, ne e kemi një donacion që e kemi fituar në shumën prej 95,000.00 €, po ky donacion ende nuk është i regjistruar në sistem, kurse ne raportin e marrim kryesisht nga ky sistem. Sa i përket rritjes së shpenzimeve për vitin 2018, është e vërtet por lirisht mundem të ju them se ne deri më tani nuk kemi asnjë obligim, nuk ka asnjë faturë në rritje për pagesë në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kjo ka qen arsyeja pse janë rritur shpenzimet.

Fehmi Cena – Sa i përket donacioneve sado që të jenë duhet që të figurojë në këtë raport në mënyrë që publiku të informohet. Pastaj në faqe nr. 24 harrova pak më parë të potencoj aty ceken shtigjet e ecjes në Rahovec ku janë paraparë më shumë se 218,000.00 €, pyetje ime është se ku do të ndërtohen këto shtigje.

Afrim Limani - I nderuar z. Fehmi Cena në mbledhje të radhës do ti kesh përgjigjet të sakta për këto pyetje.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e radhës:

3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2017.

Afrim Limani – Prezantoi para kuvendarëve Raportin e zyrës kombëtare të auditimit për vitin 2017, ku i ceku të gjeturat si dhe rekomandimet e kësaj zyre për Komunën e Rahovecit. Po ashtu e ceku se opinioni i kësaj zyre për auditimin e Komunës është klasifikuar si opinion i kualifikuar, që do të thotë se raporti nuk është vlerësuar pozitivisht.

Florije Boshnjaku – Ne këtë raport do të a diskutojmë edhe në mbledhje të kuvendit, por qeveria e kaluar nuk është aty, por ajo që është më me keqardhje është se ky raport është raport i kualifikuar, çdo ku kualifikimi është mirë ndërsa në auditim nëse dele i kualifikuar atëherë është keq. Po e gjitha që mundem me ta akuzoj qeverinë e kaluar është se ka mundur që të paguaj ndonjë shpenzim i cili ka qenë i detyruar, po ne sot nuk mundemi me e dhënë kurrfarë kontributi sepse nuk është qeveria e kaluar, sikurse të ishte ajo do të na tregonte pse nuk janë bërë pagesat. Nuk e akuzoj qeverinë e kaluar sepse nuk kamë informata të sakta pse ka ardhur deri tek ky

opinion. Pyetje ime është nga ky rekomandim që e ka dhënë auditori i përgjithshëm, komuna e Rahovecit a ka plan të veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve në mënyrë që mos të përsëriten më.

Fehmi Cena – Gjithashtu edhe ky është një raport gjithëpërfshirës i cili i takon periudhës së kaluar, megjithatë raporti i auditorit e ka rendësinë e vetë pa marrë parasysh i cilës periudhë është. Po ashtu edhe unë isha ndërlidhë me fjalimin e znj. Florije, sa janë duke u zbatuar këto rekomandime dhe a janë duke plane për zbatimin e këtyre rekomandimeve apo presim përsëri që të na përsëriten këto lëshime dhe të gjetura jo të rregullta. Qeverisë së tanishme i takon që të shikojë këtë raport dhe të bëjë një plan të veprimit sepse nëse nuk e ka do të përsëriten lëshimet e njëjta, ku pastaj do të kemi pasoja si komunë. Në mbledhje të Kuvendit do të shqyrtojmë pak më në detaje këtë raport.

Dervish Çadraku – Ashtu siç e thanë edhe parafolësit ky auditim ka të bëjë me qeverisjen e kaluar, po ka rëndësi për neve dhe për ju si qeveri që tash e tutje të mos bëjmë gabime sikurse që janë bërë deri më tani. Po ajo që është interesante jam duke parë që gjithmonë janë duke bërë të njëjtat gabime sikurse disa vite më parë dhe ashtu siç e thanë edhe parafolësit nuk ka ndonjë plan të veprimit që të përmirësohen këto gabime. Janë disa rekomandime që i ka dhënë auditori, por sa e vërejta unë janë vetëm dy raste të cilat kanë mundur të përmirësohen, kurse të tjerat gabime kanë vazhduar me vite, gabimet më të mëdha kanë ndodhur aty ku nuk është dashur të ndodhin, pra me të hyrat dhe shpenzimet. Prandaj nëse do të ketë një plan të veprimit do të ishte mirë sepse këto gjëra nuk do të përsëriten, prandaj kemi plotë gjëra të cilat kemi mundësi të i përmirësojmë në mënyrë që qeverisja të lavdërohet.

Afrim Limani – Sa i përket pyetjes së znj. Florije dhe parafolësve të tjerë se a ka Plan të Veprimit, ne së bashku si ekzekutiv e kemi lexuar raportin ku i kemi marrë edhe disa veprime ku pastaj kemi përgatitur një plan të veprimit dhe realisht ne i kemi disa plane në bazë të rekomandimeve të auditorit. Planin e veprimit si dokument ne e kemi përgatit dhe pritet që shumë shpejtë të dorëzohet në zyrën e auditimit kombëtar. Sa i përket çështjes së vlerësimit negativ të raportit, është e dhimbshme për ne të gjithë sepse si kriter nr.1 për thithjen e donacioneve të ndryshme është bazë raporti i auditorit të jashtëm dhe kriteri i dytë është realizimi i buxhetit në masën prej

75 %, në këtë rast në vitin 2017 realizimi i buxhetit ka qenë në masë të kënaqshme, por në këtë pikë kemi mbetur. Për pikën e parë e arsyetoj qeverisjen e kaluar sepse shikoni se çka ceket këtu: Shërbimet për mallra dhe shërbime me vlerë prej 77,200.00 € janë kryesisht shpenzimet e pastrimit, qeveria e kaluar nuk ka pas zgjidhje tjetër sepse kategoria për mallra dhe shërbime ka qenë e limituar nga MF dhe mbi atë limitë nuk kanë mundur me nda mjete për mallra dhe shërbime, për me e krye këtë proces është dashur të paguajnë nga investimet kapitale, një gjë që mundet edhe neve të na ndodhë ndoshta në të ardhmen. E kam pasur një takim në MF pikërisht për këtë problem, ku kam kërkuar nga ta që auditori mos ta qetë më si e gjetur negative, por të na jepet mundësia që ne të bëjmë lëvizje të kategorisë së kapitaleve dhe mallra dhe shërbime. Kurse sa i përket regjistrimit të aseteve dhe pasurisë ne si Komunë vazhdimisht e kemi pasur si problem, por ne do të mundohemi që mos të kemi më këso probleme edhe pse janë reduktuar shumë gjëra por prapë ka disa gabime dhe kjo vije pikërisht nga mungesa e profesionalizmit të zyrtarëve që i kryejnë këto punë. Si kriter tjetër ka qenë detyrimet kontingjente edhe për këtë në një farë forme e arsyetoj qeverinë e kaluar, sepse në këtë periudhë Komuna ka pasur mungesë të avokatit të Komunës dhe për këtë ka ardhur deri tek ky problem. Në momentin kur ja ka filluar avokati i ri punës është parë që ka një dallim i madh.

Kryesuesi – Ju faleminderit i nderuar, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i informatës mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së.

Rumir Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar po ju paraqes informatën e dytë rreth ecurisë së PZHK-së, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka vazhduar me punët rreth hartimit të Planit të ri Zhvillimor Komunal, po ashtu, janë mbajtur takime apo punëtori me secilën Drejtori Komunal, në të cilën janë paraqitur të gjitha planet që kanë Drejtoritë rreth zhvillimeve sektoriale që i posedojnë. Tani jemi duke e finalizuar dokumentin e gjendjes ekzistuese të PZHK-së. Në fazën e dytë do ta përgatisim Vizionin dhe Strategjinë e re të PZHK-së. Së shpejti do ta mbajmë takimin e parë me qytetarë të komunës së Rahovecit, ku para pjesëmarrësve do ta prezantojmë gjendjen aktuale, vizionin dhe strategjinë e re. Me pas do t'i mbajmë debatet publike me qytetarë nëpër lokalitetet e ndryshme të komunës së Rahovecit. Kjo

ishte nga ana ime për më shumë e keni informatën me shkrim, nëse ka dikush ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve, pasi nuk ka diskutim rreth kësaj pika, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P - 71510057- 06249 – 0.

Florije Boshnjaku – I nderuari kryesues nëse janë të pajtimit edhe kolegët e mijë, propozimi imë është që pikat të cilat na kanë mbetur të votohen si paket për mbledhje të kuvendit, për arsye se kemi edhe trajnimin në ora 11:00. Pastaj në kuvend do ti shqyrtojmë secilën veç e veç.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e znj. Florije Boshnjaku që pikët e mbetura të votohen si pako për mbledhje të kuvendit: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i znj. Florije Boshnjaku.

I qes në votim pikat si në vijim:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P - 71510057- 06249 – 0.

6. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510056 – 02240 – 1.

7. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510057 – 02267 – 0.

8. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm të parcelës komunale P – 71510068 – 01396 – 0.

Konstatohet se në mënyrë unanime janë aprovuar të gjitha pikat që të kalojnë për mbledhje të kuvendit. Kalojmë në pikën e fundit:

9. Të Ndryshme.

Fehmi Cena – I nderuari kryesues propozimi imë rreth kërkesës së kryetarit të këshillit të prindërve mendoj se ne u morëm vesh që të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës për mbledhje të kuvendit.

Florije Boshnjaku – Propozoj që për mbledhje të kuvendit të na silltet vendimi të cilin e kemi marrë ne si kuvend, pastaj a kemi nevojë ne ta ndryshojmë apo duhet të mbetet ai në fuqi në mënyrë që të lidhet me kërkesën e këtij punëtori të Komunës. Plotësisht pajtohem me këtë por duhet të dimë se kuvendi nuk merret me kërkesa individuale.

Dervish Çadraku – Mendoj se në lidhje me kërkesën e doktorit është mirë që së pari të konsultoheni me zyrën ligjore dhe pastaj në kuvend të na jepet një informatë, nëse pastaj ai nuk pajtohet me këtë konstatim atëherë ne mundemi të qesim në kuvend si pikë të rregullt. Përndryshe kjo është një rregull e cila vlen për të gjithë shërbyesit civilë, ne jemi që askujt të mos i shkelet e drejta po ashtu askujt nuk duhet të i jepen favorët.

Fehmi Cena – Nuk e di se për çfarë rregulla po fletë z. Dervish Çadraku dhe për çfarë vendimi është duke folur znj. Florije Boshnjaku, por unë jam që kjo kërkesë të jetë si pikë e rendit të ditës dhe pastaj ne do ta kemi edhe ligjin para vete, është aty edhe zyrtari ligjor i cili do ta jep arsyetimin dhe në fund do të kërkohet mendimi i yni. Por nëse ka ndonjë vendim i cili ka rregulluar pagesat e ndryshme duke përfshirë edhe për këtë që po flasim atëherë jam i mendimi që të dele ai vendim.


Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, besoj se nuk ka kurrfarë problemi që të shqyrtohet kjo kërkesë, por mendoj se nuk kishte me qenë në rregull që të trajtohet në kuvend për arsye se këshilli i prindërve për të cilin u zgjedhë ky zyrtar nuk është organ komunal, po ashtu nuk është organ obligativ. Pastaj është dashur që të cekë në kërkesën e tijë që ju ka drejtuar juve se të gjithë aktivitetin si kryetar i këtij këshilli e bënë në orar kur është në marrëdhënie pune, shtrohet pyetje a merë leje ky zotëri kur shkon në këto aktivitete, e le vendin e punës boshë në Komunë dhe shkon zhvillon aktivitet tjetër si kryetar i këshillit të prindërve. Tash na në cilën pagesë duhet me e përfshi këtë zyrtar, a duhet që të ja heqim mëditjen në ato ditë kur nuk është në vendin e punës si shef i personelit që të ja paguajmë ai anëtar i KKS-së ose të kundërtën. Po ju përmendi edhe diçka të cilën e dini edhe ju, vetëm komitetet obligative paguhen nga Komuna, kurse këshilli i prindërve nuk është obligativ, pastaj komisionet dhe këshillat dallojnë, Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për pagesën e të gjitha

anëtarëve të komisioneve të cilat formohen nga kuvendi dhe jo për shërbyes civilë, asnjë anëtar i komisionit ose kryesues i komisionit i cili është shërbyes civilë brenda orarit të punës nuk është paguar dhe as që do të paguhet. Prandaj kjo kërkesë mendoj se është jo relevante dhe jo e arsyeshme por sidoqoftë zyra ligjore do ta prezantoj në mbledhje të kuvendit me argumente dhe fakte.

Kryesuesi – A ka dikush të shtoj edhe diçka sa i përket pikës së fundit, nëse jo atëherë të nderuar anëtar të KPF-së ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.


Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:10

Procesmbajtësi


Skender Hamza



KRYESUESI


Afrim Dina